



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 249, Datë 11.12.2018

MBI

MIRATIMIN E “PROPOZIMI I GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË TË DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE NGARKESËS, NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN (BE) 2016/1719 TË DATËS 26 SHTATOR 2016 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË AVANCË”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 117; 118 - 130 të Kodit të Transmetimit të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.186 dt. 10.11.2017; **nenit 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016**; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 237, datë 02.11.2018, ka filluar procedurën për miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Europian (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë.”
- ERE me shkresën nr. 55/68 Prot., datë 07.11.2018 ka bërë njoftimin e fillimit të kësaj procedurë në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 422/5 Prot., datë 02.11.2018, ka përcjellë njoftimin e fillimit të procedurës pranë palëve të interesit.
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përkatësisht Neni 56 dhe Neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr.186 dt. 10.11.2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sha,) në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.

- Dokumenti vjen nga OST sha në vijim të komunikimit Nr. 3886 prot. datë 25.05.2018 me objekt: “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 188, Datë 20.08.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.
- Dokumenti i përbërë nga 19 nene, saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës së nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët, nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë me qëllim përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian, inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”. (Bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI